



○ Grupi për Qasje në Zgjedhje
○ Grupa za Pristup Izborima.
○ Election Access Group

UDHËZUES

**PËR PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA PËR PJESËMARRJE
NË PROCESET ZGJEDHORE DHE POLITIKE**

Qershor
2016





Udhëzues për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar në Proceset Zgjedhore dhe Politike
Të drejtat e autorit ©2016 Grupi për Qasje në Zgjedhje.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky udhëzues është përgatitur nga Grupi për Qasje në Zgjedhje, i mbështetur nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) dhe financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij udhëzues është përgjegjësi e vetme e Grupit për Qasje në Zgjedhje (GQZ) dhe nuk mund të konsiderohet pasqyrim i qëndrimeve të IFES dhe USAID.

Deklaratë e lejes: Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet në asnjë formë me çfarëdo mjeti, elektronik apo mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, apo nga një sistem tjetër për ruajtjen e informacionit dhe rikthimin e tij pa lejen me shkrim nga GQZ.



Ky udhëzues ka për qëllim të ofroj ndihmë praktike për institucionet publike, subjektet politike dhe shoqërinë civile në Kosovë, në lidhje me mënyrat më të mira të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore dhe politike. Po ashtu udhëzuesi ofron edhe të dhëna në lidhje me kërkesat ligjore në lidhje me qasjen e personave me aftësi të kufizuar në objektet publike. Përdoruesit e udhëzuesit do të mund të identifikojnë forma dhe mënyra për të përfshirë personat me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore, në kapacitete të ndryshme dhe në jetën politike në vend.

Përmbajtja

Njoftim me Grupin për Qasje në Zgjedhje	6
Pjesa 1 Udhëzime për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore dhe politike	7
Hyrje	8
Pse është e rëndësishme përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe politike?	9
Definicionet dhe legjislacioni	9
Çka mund të bëjë Kuvendi i Kosovës?	10
Çka mund të bëjnë subjektet politike?	12
Çka mund të bëjnë organizatat e shoqërisë civile?	16
Çka mund të bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve?	19
Çka mund të bëjë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa?	21
Çka mund të bëjnë shoqatat e personave me aftësi të kufizuara?	23
Çka mund të bëjë Avokati i Popullit?	24
Çka mund të bëjë Qeveria e Kosovës?	26
Çka mund të bëjë sektori privat?	26
Pjesa 2 Personat me aftësi të kufizuar si lider/e	29
Argjentinë	30
Australi	30
Belgjikë	30
Ekuador	30
Figji	30
Greqi	30
Indonezi	31
Kanada	31
Mbretëri e Bashkuar	31
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	31
Zelandë e Re	31
Pjesa 3 Standardet bazike për qasje	33
Objektet të cilat janë të obliguara të sigurojnë qasje sipas udhëzimit administrativ	34
Si të bëhet qasja?	39

Njoftim me Grupin për Qasje në Zgjedhje

Grupi për Qasje në Zgjedhje (GOZ) është grup punues me shumë hisedarë qëllimi i të cilit është pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe në jetën publike. Grupi përbëhet nga përfaqësuesit e organizatave që përfaqësojnë katër lloje të aftësive të kufizuara (z. Afrim Maliqi, HandiKOS, znj. Rukije Gashi, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, z. Daut Tishuki, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, dhe znj. Sebahate Beqiri, Shoqata Down Syndrome Kosova), dy anëtarë të Kuvendit të Kosovës (znj. Ganimete Musliu dhe z. Salih Morina), dy përfaqësues të Komisionit Qendror Zgjedhor të Kosovës (z. Florian Dushi¹, dhe z. Nexhmedin Hyseni), një përfaqësuese e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (znj. Valbona Millaku), dhe dy përfaqësues nga Qeveria (znj. Luljeta Kabashi, Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, dhe z. Qazim Gashi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale). GOZ kryesohet nga z. Afrim Maliqi dhe nga nënkryesuesja, znj. Ganimete Musliu.

Grupi mirëpret kontributin e të gjithë hisedarëve në përpjekjet e tij për të promovuar qasje për personat me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore dhe në jetën publike.

¹Gjatë zhvillimit të këtij Udhëzuesi, Z. Florian Dushi ka qenë anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe bashkëkryesues dhe anëtar i Grupit për Qasje në Zgjedhje.

PJESA

1

Udhëzime për përfshirjen e
personave me aftësi të
kufizuara në procese
zgjedhore dhe politike

Hyrje

Ky udhëzues ofron informata për përfaqësuesit e institucioneve publike, subjekteve politike dhe shoqërisë civile, me format më adekuate të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Në këtë dokument përshkruhen nevojat dhe specifikat që kanë grupet e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të kontribuojnë në mënyrë aktive në procesin zgjedhore dhe sektorin politik në Kosovë.

Udhëzuesi është hartuar duke marr parasysh kërkesat dhe nevojat e vet personave me aftësi të kufizuara, dokumenteve dhe strategjive të Grupit për Qasje Zgjedhore (GOZ), ligje dhe udhëzime administrative. Udhëzuesi ofron këshilla praktike për institucionet publike, subjektet politike, shoqërinë civile, trupat zgjedhore dhe vet shoqatat e personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu adresohen problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të përmirësoj kushtet dhe rrethanat për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike.

Bazuar në të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, vlerësohet se numri i personave me aftësi të kufizuara të çfarë do natyre qofshin ato, përbën 15% të popullsisë. Numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, konsiderohet të jetë 150,000 – 200,000. Përderisa numri i personave është mjaft i lartë, dallojnë llojet e aftësive të kufizuara dhe rrjedhimisht edhe nevojat specifike të këtyre grupeve për t'u përfshirë në jetën publike dhe procese zgjedhore. Një numër kaq i madh i individëve është shumë domethënës për shkak se paraqet një potencial të konsiderueshëm për skenën politike. Për më tepër përfitimet e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara do të ishin të dy anshme. Në njërën anë subjektet politike, do të rrisnin numrin e votave, numrin e anëtarësisë dhe vullnetarëve. Në anën tjetër personat me aftësi të kufizuara do të përfitonin më shumë mundësi për angazhim në jetën publike, të kandidohen për t'u zgjedhur, zhvillojnë shkathtësitë e tyre në kuadër të mundësive që japin subjektet politike në Kosovë dhe të tjera. Duke përdorur këtë udhëzues të gjitha këto grupe do të kenë më të lehtë të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në strukturat e tyre.

Pse është e rëndësishme përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe politike?

Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara është e garantuar me legjislacion ndërkombëtar dhe vendor, si një e drejtë elementare njerëzore. Personat me aftësi të kufizuara paraqesin një potencial shoqërorë i cili mund të kthehet në avantazh politik dhe ekonomik.

Në anën tjetër mos përfshirja e këtyre personave, mund të kthehet në barrë të shoqërore. Personat me aftësi të kufizuara janë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe si të tillë ata mund të

japin kontribut të çmuar në diversifikimin e spektrit politik dhe zhvillimit shoqëror. Po ashtu të njëjtit mund të kontribuojnë në proceset zgjedhore në Kosovë, duke ndihmuar në organizimin dhe menaxhimin e proceseve zgjedhore. Institucionet publike, subjektet politike dhe vetë shoqëria civile, do të përfitojnë nga përfshirja e personave me aftësi të kufizuara dhe në të njëjtën kohë do të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në vend.

Definicionet dhe legjislacioni

Në bazë të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK), termi person me aftësi të kufizuara përfshin "të gjithë ata personat të cilët kanë për një kohë më të gjatë dëmtim fizik, mental, intelektual apo shqisore, i cili në ndërveprim me barrierat e sjelljeve dhe ambientit, pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët"². Personat të cilët kanë aftësi të kufizuara të përkohshme, nuk mund të konsiderohen si pjesë e personave

me aftësi të kufizuara. Sidoqoftë, varësisht nga legjislacionet nacionale një aftësi e kufizuara mund të mos konsiderohet si e tillë në një shtet tjetër.

Në Kosovë me ligj aftësia e kufizuara përkufizohet si "kufizim i qasjes dhe aktiviteteve të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore ose mendore, që e pengojnë pjesëmarrjen në aktivitetet e zakonshme ditore"³. Legjislacioni i Kosovës i është përshtatur në masë të madhe definimit që i ka bërë

²Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Neni 1. 2006.

³Ligji Nr. 03/L-019 i Republikës së Kosovës për aftësimin, riaftësimin profesional, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. 2009.

aftësisë së kufizuar Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Subjektet politike, shoqëria civile dhe palët e tjera të interesit, mund të ndërmarrin një numër të masave dhe veprimeve për të siguruar qasjen dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar bazuar në nevojat e tyre. Pengesat për pjesëmarrje duhet analizuar me kujdes nga secila palë e interesit, duke u bazuar në rrethanat specifike të lokacionit, kulturës dhe rrethanave të tjera përcjellëse të cilat vështirësojnë apo pengojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe proceset zgjedhore.

Çka mund të bëjë Kuvendi i Kosovës ?

Si institucioni më i lartë demokratik në vend, Kuvendi i Kosovës ka një rol shumë të gjerë në përmirësimin e pozitës shoqërore të të gjitha grupeve të marginalizuara të qytetarëve, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar. Nëpërmjet autoritetit ligjvënës, Kuvendi mund që në mënyrë efektive të ndihmojë personat me aftësi të kufizuar të përfshihen në proceset zgjedhore. Në këtë aspekt Grupi për Qasje Zgjedhore rekomandon që Kuvendi:

- 1** Të shndërroj në Ligj, Udhëzimin Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- 2** Të plotësoj edhe më tutje bazën ligjore për mbrojtjen dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar;
- 3** Në bashkëpunim me grupet parlamentare dhe subjektet politike, t'i përfshijë në proceset e konsultimeve publike personat me aftësi të kufizuar;
- 4** Përfshij çështjen e personave me aftësi të kufizuar si përgjegjësi të Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Së bashku me vet personat me aftësi të kufizuar, shoqatat e tyre, Komisioni të shqyrtoj të gjitha draft ligjet nga perspektiva e aftësisë së kufizuar.

Kuvendi i Kosovës ka për përgjegjësi të siguroj qasje për personat me aftësi të kufizuar në mënyrë që t'u mundësoj atyre t'i shërbejnë komunitetit të tyre si zyrtarë të zgjedhur si deputet apo ministra, të jenë prezent si informatorë të Kuvendit apo komisioneve parlamentare në dëshmi apo shqyrtime të matjes së performancës së përfaqësuesve të tyre në Kuvend. Kuvendi ka për obligim të:

- 5 Siguroj qasje të mjaftueshme fizike për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha hapësirat publike apo përfaqësuese të Kuvendit;
- 6 Lehtësira të tjera mbështetëse të tilla si personel shtesë dhe të pajisur për të mundësuar përfaqësuesve me aftësi të kufizuara që të kryejnë përgjegjësitë e tyre në mënyre efektive;
- 7 Materialet në shqyrtim të jenë në formate të qasshme për personat me aftësi të kufizuar, të tilla si shkrimi Braille, me printim të formatit të zmadhuar apo audio;
- 8 Ofroj qasje në informacione dhe ndërveprim të përfaqësuesve të Kuvendit nëpërmjet të gjuhës së shenjave, duke siguruar interpret.

Çdo institucion publik duhet të ketë komponentet bazike për qasje të personave me aftësi të kufizuar:

- Rampën dhe ashensorin e përshtatshëm për qasje të personave me karrocë apo aftësi të tjera të kufizuara fizike;
- Dyer të gjera mjaftueshëm për qasje të personave me karrocë;
- Hapësirë të mjaftueshme në korridore dhe dhoma për lëvizje me karrocë;
- Dysheme të pa rrëshqitshme dhe shmang objektet e varura në mure të cilat mund të pengojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar;
- Tualete plotësisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara fizike, duke përfshirë lartësinë e përshtatshme të instalimeve të pajisjeve, hapësirë të mjaftueshme për lëvizje me karrocë dhe rampat.

Figura 1: Komponentat bazike të qasshmërisë

Në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Kuvendi zgjedh dhe emëron pozitat më të rëndësishme në kuadër të administratës shtetërore. Në këtë aspekt GQZ rekomandon Kuvendit që:

9 Të emëroj persona me aftësi të kufizuar në bordet e agjencioneve të pavarura dhe pozita të tjera të ngjashme.

Kuvendi ka autoritet mbikëqyrës, në raport me zbatimin e ligjeve dhe punën e institucioneve të cilat raportojnë në Kuvendin e Kosovës, GQZ i rekomandon Kuvendit të:

10 Monitoroj zbatimin e ligjeve që rregullojnë çështjen e personave me aftësi të kufizuar;

11 Thërras në raportim dhe përgjegjësi ministrat dhe drejtuesit e tjerë të institucioneve të pavarura që nuk zbatojnë ligjet.

Çka mund të bëjnë subjektet politike ?

Subjektet politike në Kosovë mund të ndërmarrin disa veprime të cilat do të mundësonin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar. Këto veprime përfshijnë çështjet teknike, si qasja fizike në objekte dhe vendet e tjera të punës e po ashtu promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në çështjet e subjekteve politike duke përfshirë zgjedhjet e brendshme partiake dhe zgjedhjet për kandidat në zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet qendrore.

Qasja e përgjithshme fizike

Personat me aftësi të kufizuar kanë nevojë për qasje të plotë fizike në të gjitha nivelet e organizimit partiak duke përfshirë nën-degët, degët dhe qendrat e tjera të subjekteve politike. Pengesat fizike përfshijnë por nuk kufizohen në, shkallë, pragje të larta, pengesat, dyshemetë e rrëshqitshme, kalimet e ngushta dhe tualete të pa qasshme për personat me aftësi të kufizuar.

Mungesa e rampës në objekte është jashtëzakonisht dekurajuese për personat me aftësi të kufizuara fizike. Në këtë rastë ata duhet të barten nga persona të tjerë për të lëvizur në këto objekte.

Shumë zyra të subjekteve politike në Kosovë nuk kanë qasje fizike për personat me aftësi të kufizuar. Madje, edhe në ato rastë kur është tentuar të ndërtohen këto pajisje përcjellëse, ato në disa rastë nuk i arrijnë kërkesat minimale ligjore,

për shembull pjerrtësia e rampave është e rrëpirë apo tualetet janë shumë të ngushta.

GQZ i rekomandon subjekteve politike të sigurojnë që të gjitha zyrat dhe vendet ku mbahen tubime elektorale të përmbushin standardet bazike të qasshmërisë të listuara në Figurën 1.

Iniciativat e subjekteve politike për të përfshirë personat me aftësi të kufizuar

Angazhimet e subjekteve politike për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar nuk përfundojnë me modifikimin e objekteve dhe sigurimin e qasjes fizike. Në Kosovë ka pasur pak inkurajim për inkudrimin e personave me aftësi të kufizuar në politikë.

Ka pasur numër të vogël të personave me aftësi të kufizuar që janë përfshirë në aktivitetet e subjekteve politike si anëtarë dhe kandidatë për t'u zgjedhur në poste publike apo zgjedhjet e brendshme të partive.

GQZ i rekomandon subjekteve politike të promovojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet e tyre duke:

- 1** Bashkëpunuar aktivisht me personat me aftësi të kufizuar të cilët kanë qenë të përfshirë në gara elektorale në zgjedhje të brendshme partiake, zgjedhje komunale apo parlamentare, që të ndërtojnë dialog dhe raport me komunitetin e personave me aftësi të kufizuar;
- 2** Ofroj interpretim në gjuhën e shenjave për të gjitha materialet programore të formatit audio dhe vizuele dhe në takimet e tjera;
- 3** Krijimin e lidhjeve me organizatat dhe forumet e personave me aftësi të kufizuar;
- 4** Përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në aktivitete, kampanja dhe evente të tjera;
- 5** Inkurajimin e personave me aftësi të kufizuar për të garuar në zgjedhjet e brendshme partiake në kuadër të degëve, nëndegëve dhe nivel qendror;
- 6** Përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në listat e kandidatëve për zgjedhjet komunale, qendrore dhe në zgjedhjet për kryetarë komunash;
- 7** Emërimin e personave me aftësi të kufizuar në pozita partiake, si për shembull në kampanjat elektorale apo edhe si vëzhgues të zgjedhjeve;

- 8** Nominimin e personave me aftësi të kufizuar si personel në Komision Komunal Zgjedhor dhe komisioner në qendrat e votimit;
- 9** Përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në fushatë elektorale dhe takime.

Integrimi i aftësisë së kufizuar në politika dhe platforma të subjekteve politike

Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në draftimin e politikave dhe platformave politike mund të siguroj që nevojat e tyre të adresohen në këto dokumente.

GQZ rekomandon që subjektet politike të:

- 10** Konsultohen me personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre gjatë draftimit të programeve, politikave dhe platformave;
- 11** Përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në ekipet e draftimit të programeve, politikave dhe platformave;
- 12** Përdorin formate të qasshme për politikën, platformat dhe materialet e fushatës, si për shembull duke përdorur printimin në formate të zmadhuara apo të shkruara në Braille për materialet e printuara dhe gjuhën e shenjave për spotet televizive.

Themelimi i forumeve të personave me aftësi të kufizuar

Subjektet politike duhet të sigurojnë se kanë dialog të vazhdueshëm dhe të strukturuar në mes të subjekteve politike dhe personave me aftësi të kufizuar. Themelimi i forumeve partiake për personat me aftësi të kufizuar, të ngjashme me ato të të rinjve dhe grave është një formë nëpërmjet të cilës subjektet politike mund të sigurojnë përfaqësim të personave me aftësi të kufizuar në strukturat e tyre.

Përkundër që forumet e tilla krijojnë përshtypjen e ndarjes së personave me aftësi të kufizuar nga pjesa tjetër e strukturave kryesore partiake, ky diskriminim pozitiv do të mund të siguronte një zgjidhje tranzitore. Kjo do të

vazhdonte deri sa të sigurohet një pjesëmarrje më e madhe e personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet e përgjithshme të subjekteve politike. Për më tepër, nëpërmjet këtij forumi personat me aftësi të kufizuar do të kishin mundësinë të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre, pas së cilës subjektet politike do të donin t'i përfshinin personat me aftësi të kufizuar për interesin e tyre. Po ashtu do të mund të përdoret si formë hyrëse për përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në organet menaxhuese të subjekteve politike.

GOZ u rekomandon subjekteve politike të:

- 13** Themelojnë një forum për personat me aftësi të kufizuar në kuadër të strukturës së subjekteve politike, si formë tranzitore për të promovuar dialogun me personat me aftësi të kufizuar dhe për të siguruar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në organet menaxhuese të subjektit politik.

Caktimi i deputetit përfaqësues në kuadër të grupeve parlamentare

Një strukturë për bashkëpunimin në mes të grupeve parlamentare dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuar do t'i ndihmonte personat me aftësi të kufizuar për të tërhequr vëmendje në shqetësimet dhe nevojat e tyre.

Këta deputet do të pritej që të angazhoheshin në edukimin e kolegëve të tyre deputetë, ministrat e kabinetit qeveritar dhe qytetarët në përgjithësi, duke rritur vetëdijen e tyre për çështjet e aftësisë së kufizuar. Ata mund të thërrasin në përgjegjësi ministrat apo anëtarët e tjerë të Qeverisë për të diskutuar çështjet me interes për personat me aftësi të kufizuar. Ata po ashtu mund të ushtrojnë ndikim në Kuvendin e Kosovës që të siguroj se personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre ftohen të marrin pjesë në dëgjimet publike dhe ngjarjet e tjera ku të drejtat e tyre diskutohen. Po ashtu të njëjtit sigurojnë që materialet në Kuvend do të sigurohen në format të qasshme për personat me aftësi të kufizuar.

GOZ i rekomandon subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend dhe kuvende komunale që të:

- 14** Caktojnë një anëtarë në çdo grup parlamentar i cili do të ishte pikë kontakti për t'u marr me shqetësimet dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar si kandidat në zgjedhje

Ka dy arsye pse subjektet politike kanë interes në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në listën për kandidat në zgjedhje. Duke u marr me këtë komunitet, në njërën anë subjektet politike do të rrisin numrin e votuesve të tyre duke e targetuar një segment të popullsisë i cili është shumë pak i përfaqësuar. Në anën tjetër sipas të gjitha gjasave kjo do të ngriste numrin e përgjithshëm të votuesve dhe legjitimitetin e zgjedhjeve në përgjithësi.

GQZ i rekomandon subjekteve politike që të:

- 15** Përfshijnë personat me aftësi të kufizuar në listën si kandidatë për zgjedhjet qendrore, komunale dhe si kandidatë për kryetarë të komunave;
- 16** Nominojnë persona me aftësi të kufizuara për pozita në kabinetin qeveritar.

Çka mund të bëjnë organizatat e shoqërisë civile ?

Ka shumë mënyra se si organizatat e shoqërisë civile mund të përkrahin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në procese politike, zgjedhore dhe jetën publike. Përveq avokimit dhe monitormit, ato mund të rrisin ndikimin e tyre në këtë aspekt, duke u bërë model i përfshirjes. Kjo do të përfshinte masat si: sigurimi i qasjes fizike në lokalet e tyre, angazhimi i personave me aftësi të kufizuar në si personel si dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet e tyre. Po ashtu ato do të mund të përfshijnë aftësinë e kufizuar në të gjitha punët që ato bëjnë.

Monitorimi

Organizatat e shoqërisë civile do të duhej të ishin një aleat i fortë i personave me aftësi të kufizuar, kjo pasi që çështja e aftësisë së kufizuar, natyrshëm është një mision për të cilin këto organizata angazhohen. Monitorimi i zbatimit të ligjeve të aplikueshme në Kosovë, në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar do të ishte një kontribut i çmueshëm për komunitetin e aftësisë së kufizuar.

Duke pasur raporte nga organizata të cilat nuk janë pjesë e komunitetit të organizatave që angazhohen të personave me aftësi të kufizuar, do të sigurohej një vlerësim i pavarur dhe më i besueshëm. Organizatat e shoqërisë civile do të mund të bashkëpunojnë me organizatat e personave me aftësi të kufizuar në monitorimin e zbatimit të ligjeve. Kjo do të siguronte eksperiencë të gjerë dhe objektivitet me specialist që njohin çështjet e aftësisë së kufizuar.

GQZ i rekomandon organizatave të shoqërisë civile të:

- 1** Monitorojnë zbatimin e ligjeve në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;
- 2** Ku është e mundur dhe efektive, të formohen partneritet në me organizatat e personave me aftësi të kufizuar për monitorim.

Edukimi dhe Avokimi

Kampanjat për edukim dhe avokim do të mund të promovonin të drejtave për përfaqësim dhe përfshirje të personave me aftësi të kufizuar në jetën publike, në listat e kandidatëve të subjekteve politike, në lista për vëzhgues dhe personel zgjedhor. Kjo do të mund të përfshinte organizatat e shoqërisë civile të cilat do të ushtronin presion në subjektet politike, përmes promovimit të shembujve të mirë të subjekteve të cilat tregojnë vullnet më të madh për përfshirje dhe plotësojnë më shumë kushte që personat me aftësi të kufizuar të bashkohen në këto subjekte. Për më tepër shembujt e subjekteve politike të cilat angazhohen më pak në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar do të publikoheshin.

Organizatat e shoqërisë civile do të mund të organizonin fushata më të gjera për të promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore dhe jetën publike. Kjo do të bëhej duke përdorur mediat tradicionale dhe ato të reja, me qëllim të rritjes sa më të madhe të audiencës së targetuar dhe rritjes së efektivitetit të fushatës. Përmes këtyre fushatave do të ngritej vetëdija e përgjithshme qytetare në lidhje me personat me aftësi të kufizuara.

Do të trajtoheshin çështjet e tilla si stigmatizimi, stereotipet në lidhje me personat me aftësi të kufizuar, e po ashtu edhe mos përfshirja në arsim dhe çështje tjera të rëndësishme e personave me aftësi të kufizuar. Organizatat e shoqërisë civile do të mund po ashtu të bënin kampanjë kundër terminologjisë diskriminuese e cila përdoret në referimin e personave me aftësi të kufizuar, duke e përdorur Manualin e GQZ për Terminologjinë dhe Qasjen Korrekte për Personat me Aftësi të Kufizuar.

GQZ i rekomandon organizatave të shoqërisë civile që të:

- 3** Organizojnë fushata edukuese dhe avokuese për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për përfshirje në proceset zgjedhore dhe politike;
- 4** Duke publikuar shembujt e mirë dhe të këqij të subjekteve politike të cilat përfshijnë personat me aftësi të kufizuar, të bëjnë presion në subjektet politike të sigurojnë më shumë mundësi për përfshirjen e tyre;
- 5** Bëjnë fushatë kundër përdorimit të terminologjisë diskriminuese në raport me personat me aftësi të kufizuar.

Strukturimi i bashkëpunimit

Organizatat e shoqërisë civile dhe veçanërisht ato të cilat kanë përvojë më të gjatë në fushën e avokimit dhe demokratizimit do mund të ofrojnë një kontribut të çmueshëm në fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar. Këto organizata mund to ofrojnë forma të ndryshme të përkrahjes, për shembull në lidhje me:

- Ofrimin e informacioneve në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, shërbimet dhe qasjen në objektet për të cilat ata kanë të drejtë;
- Konsultimi nëpërmjet grupeve jo-formale dhe formale për të shkëmbyer informacione në lidhje me ambientin politik;
- Avokimi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe trajnimi për avokim i personave me aftësi të kufizuar dhe shoqatave të tyre;
- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë menaxhmentin dhe aktivitetet. Koordinimi i monitorimit dhe këshillimi i organizatave të personave me aftësi të kufizuar në monitorimin e legjislacionit për qasje të personave me aftësi të kufizuar si dhe në politikat e institucioneve dhe praktikat në qasje për personat me aftësi të kufizuar.

Secila nga këto katër forma të bashkëpunimit do të strukturohej përmes themelimit të grupeve apo këshillave jo formale të bashkëpunimit në mes të organizatave dhe personave me aftësi të kufizuar. Kjo do të ndihmonte që personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre përfaqësuese të përfshihen në monitorim të institucioneve dhe proceseve të rëndësishme të tilla si zgjedhjet apo puna e institucioneve.

GOZ i rekomandon organizatave të shoqërisë civile të:

- 6 Punoj me shoqatat e personave me aftësi të kufizuar për të formuar një komision të bashkëpunimit për të avokuar, informuar, konsultuar në çështjet e lidhura me zgjedhje dhe pjesëmarrje politike të personave me aftësi të kufizuar.

Çka mund të bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ?

Si institucion i cili organizon dhe menaxhon procesin zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka një rol kyç në promovimin e përfshirjes në proceset zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar. Roli dhe detyrat e KQZ-së kryqëzohen në një numër të fushave me çështje të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuar, duke përfshirë:

- Qasje fizike në ndërtesat të cilat shfrytëzohen si qendra të votimit, zyrat qendrore dhe lokale të KQZ-së si dhe të pajisjeve dhe objekteve të përdorura për aktivitete zgjedhore;
- Qasje në materialet administrative zgjedhore dhe sistem, të tilla si materiali i votimit, materialet e regjistrimit të votuesve, format e rekrutimit dhe sistemet, rezultatet zgjedhore;
- Qasje në materialet e informimit dhe edukimit të votuesve, për shembull për personat e verbër dhe shurdhër;
- Rishikimi dhe amendamenti i rregulloreve, udhëzimeve, procedurave dhe materialeve të trajnimit;
- Përfshijë në personel zgjedhor persona me aftësi të kufizuar në nivel qendror dhe lokal;
- Punësimi i përkohshëm dhe i përhershëm i personave me aftësi të kufizuar.

Qasja fizike në ndërtesat e përdorura për qëllime zgjedhore dhe materialet zgjedhore të KQZ-së kërkon që KZQ të merr masa për të ofruar qasje të papenguar të personave me aftësi të kufizuar në mënyrë që ata të marrin pjesë plotësisht si votues, personel zgjedhor apo vëzhgues. Kështu personat me aftësi të kufizuar do të jenë të gatshëm të luajnë një rol të plotë dhe të informuar si votues, personel zgjedhor, kandidat apo vëzhgues. Për t'u arritur kjo, së pari duhet që të gjitha materialet administrative dhe zgjedhore të bëhen të qasshme nga KQZ, në formate të cilat kuptohen nga personat me aftësi të kufizuar. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të verbër, të shurdhër apo aftësi të kufizuar intelektuale. Dispozitat e qasshmërisë duhet të jenë të sqaruara qartë në rregulloret, udhëzimet, politikat, procedurat dhe materialet e trajnimit.

Punësimi i personave me aftësi të kufizuar të kualifikuar, si personel i përhershëm apo i përkohshëm, shërben edhe si shembull për inkurajim të personave të tjerë me aftësi të kufizuar për të shprehur interesimet e tyre në proceset zgjedhore. Po ashtu i mundëson KQZ-së të arrij standardin ligjor⁴ dhe zotimin e bërë përmes memorandumit të bashkëpunimit⁵ për të punësuar të paktën një person me aftësi të kufizuar në çdo 50 punëtor.

GQZ i rekomandon KQZ-së të:

- 1** Rishikoj dhe amendamentoj rregulloret e veta dhe aktet e tjera ligjore në mënyrë që standardet e qasshmërisë që u mundëson personave me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në mënyrë të plotë në të gjitha aspektet e proceseve zgjedhore, të bëhen obligative;
- 2** Rishikoj dhe amendamentoj politikat, procedurat dhe materialet e trajnimit për të përfshirë referencë specifike se si KQZ do të ofroj qasje për personat me aftësi të kufizuar për të marr pjesë në zgjedhje në të gjitha aspektet;
- 3** Siguron se zyrat e KQZ dhe Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe objektet e përdorura për nevojat të zgjedhjeve, të tilla si procedimi i votave nga jashtë, numërimi etj, janë fizikisht të qasshme. Kjo përmes rampave, ashensorëve, tualeteve të qasshme, eliminimi i barrierave dhe hapësira e mjaftueshme për lëvizje me karrocë;
- 4** Siguroj se në qendrat e votimit:
 - a** Ka qasje fizike për personat me aftësi të kufizuar në lokale, përmes rampës, ashensorëve, qasje në tualete, largimi i barrierave dhe hapësirë e mjaftueshme për lëvizje me karrocë;
 - b** Kabinat e votimit të arritshme për personat me karrocë;

⁴Ligji Nr. 03/L-019 i Republikës së Kosovës për aftësimin, riaftësimin profesional, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar. 2009. Neni 12.2.

⁵Memorandumi i bashkëpunimit në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe HandiKOS, Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve, si dhe Shoqatës Down Syndrome Kosova. 16 tetor 2015.

- c** Kutit e votimit të jenë të vendosura në atë formë që personat me karrocë të arrijnë të hedhin votën e tyre;
 - d** Shabllonet e fletëvotimeve në shkrimin Braille të jenë në dispozicion në çdo qendër të votimit.
- 5** Ofron materialet e administrimit të zgjedhjeve dhe sistemet të tilla si materialet e votimit, materialet e lidhura me regjistrimin e votuesve, format e rekrutimit dhe sistemet dhe rezultatet e zgjedhjeve në formate të kuptueshme dhe të qasshme për personat e verbër, shurdhër dhe aftësi të kufizuar intelektuale;
- 6** Siguron edukim të votuesve dhe materiale informuese në format të kuptueshëm dhe të qasshëm për personat personat e verbër, shurdhër dhe aftësi të kufizuara intelektuale. Kjo përfshin:
- a** Materialet e printuara, spotet televizive dhe materialet elektronike përdorin kontrast të lartë të ngjyrave;
 - b** Këto materiale përmbajnë informata të thjeshta dhe të qarta;
 - c** Materialet për televizione, ueb faqe dhe mediat sociale prezantojnë mesazhe në audio dhe gjuhën e shenjave; dhe
 - d** Materialet e printuara janë në dispozicion në format që është i kuptueshëm nga personat e verbër, duke përfshirë shkrimin Braille.
- 7** Punësoj persona me aftësi të kufizuar si personel të përkohshëm dhe të përhershëm, të paktën në nivelin e kërkuar me ligj.

Çka mund të bëjë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa?



Si organ i cili trajton të gjitha ankesat dhe parashtresat në procesin zgjedhor dhe ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, PZAP është me rëndësi të operoj në mënyrë të qasshme për personat me aftësi të kufizuar. Kjo nuk përfshin vetëm qasjen fizike në lokacionet e PZAP-së, por edhe qasje në informacionet në lidhje funksionimin e PZAP-së, për ligjet që zbaton dhe për metodat e ankesave, parashtresave dhe dokumenteve të tjera mbështetëse.

GQZ i rekomandon PZAP-së të:

- 1** Rishikoj dhe amendamentoj rregulloret e veta dhe aktet e tjera nënligjore, në përputhshmëri me Ligjin për Zjedhje të Përgjithshme, në mënyrë që standardet e qasshmërisë që ua mundësojnë personave me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në parashtrimin e ankesave, parashtresave dhe monitorimin e shqyrtimit të ankesave, parashtresave, të jenë obligative;
- 2** Rishikoj dhe amendamentoj politikat, procedurat, materialet e trajnimit që të përfshijë referenca specifike se si PZAP do të ofroj qasje për personat me aftësi të kufizuara, për të parashtruar ankesat dhe monitoruar procesin e ankesave dhe parashtresave;
- 3** Siguroj se ka qasje fizike për personat me aftësi të kufizuar në zyrat e PZAP-së, për shembull përmes rampave dhe ashensorëve, tualetet e qasshme, eliminimin e pengesave dhe hapësirë të mjaftueshme për lëvizje me karrocë. PZAP duhet të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së një tavoline ndihmëse në katin përdhësë për të pranuar ankesat dhe parashtresat e personave me aftësi të kufizuar, gjatë periudhës së zgjedhjeve;
- 4** Kur është e lejuar me ligji të lejoj parashtrimin e ankesave dhe parashtresave përmes mjeteve të komunikimit elektronik, për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar në arritjen e afateve të shkurtra;
- 5** Siguroj interpret të gjuhës së shenjave në zyrat e PZAP-së gjatë periudhës së zgjedhjeve kur ankesat dhe parashtresat mund të dorëzohen, procedohen dhe vendosen;
- 6** Siguroj materialet administrative dhe sistemet në format i cili është i kuptueshëm dhe i qasshëm nga personat e verbër, shurdhër dhe aftësi të kufizuar intelektuale;
- 7** Siguroj që të gjitha materialet edukuese në lidhje me funksionimin e saj të jenë në format të kuptueshëm dhe të qasshëm për personat e verbër, shurdhër dhe aftësi të kufizuar intelektuale. Kjo përfshinë sigurimin e:
 - a** Materialet e printuara, televizive dhe elektronike përdorin kontrast të lartë të ngjyrave;
 - b** Këto materiale përmbajnë informacion të qartë dhe të thjeshtë;
 - c** Materialet televizive, ato për ueb faqe, rrjete sociale përfshijnë mesazhe në audio dhe në gjuhë të shenjave; dhe

- d** Materialet e printuara janë në dispozicion në formate të cilat janë të kuptueshme nga persona e verbërit, duke përfshirë shkrimin Braille;

- 8** Punësoj persona me aftësi të kufizuar në personel, të paktën në nivelin e kërkuar me ligj.

Çka mund të bëjnë shoqatat e personave me aftësi të kufizuara



Shoqatat e personave me aftësi të kufizuar luajnë një rol kritik në avokimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit, i cili lidhet me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore. Për të përmbushur këtë rol në mënyrë efektive, këto shoqata duhet të sigurohen që ato janë duke mobilizuar në mënyrë efektive anëtarët e tyre dhe anëtarët potencial dhe të koordinojnë avokimin e tyre në mënyrë që t'i shërbejnë personave me aftësi të kufizuar. Ata duhet të kujdesen që rolet e tyre si avokues dhe zbatues të projekteve të dhënies së shërbimeve dhe monitorues të performancës së agjencie qeveritare nuk përbëjnë në ndonjë formë konflikt të interesit.

GQZ i rekomandon shoqatave të personave me aftësi të kufizuar që të:

- 1** Mobilizojnë persona me aftësi të kufizuar për të marr pjesë në zgjedhje;
- 2** Organizojnë fushata për edukimin e publikut në proceset zgjedhore dhe politike mbi personat me aftësi të kufizuara;
- 3** Trajtojnë dhe rrisin kapacitetet e personave me aftësi të kufizuar për të kandiduar në zgjedhje;
- 4** Nxisin dhe përkrahin personat me aftësi të kufizuar për punësim në trupat menaxhuese zgjedhore;
- 5** Edukojnë dhe informojnë institucionet publike, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore dhe politike;

- 6** Angazhojnë në avokim të përbashkët tek subjektet politike duke krijuar platforma të përbashkëta të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar;
- 7** Monitorojnë zotimet e KQZ-së për punësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe të monitorohet PZAP në lidhje me zbatimin e ligjeve për punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- 8** Rrisin bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës, Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që projektligjet të analizohen nga këndi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar;
- 9** Ofrojnë ekspertizë dhe ndihmë për Qeverinë dhe Kuvendin në procesin e draftimit të ligjeve në kuadër të grupeve punuese;
- 10** Rrisin bashkëpunimi me organizatat e tjera të shoqërisë civile me qëllim të ndërveprimit dhe rritjes së efikasitetit në avokim;
- 11** Ndihmojnë personat me aftësi të kufizuar në ndryshimin e qendrave të votimit sipas nevojës.

Çka mund të bëjë Avokati i Popullit ?

Si institucion i specializuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit duhet t'i kushtoj vëmendje të shtuar problemeve të personave me aftësi të kufizuar. Kjo për shkakun se personat me aftësi të kufizuar janë më të ekspozuar ndaj shkeljeve elementare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat në procese zgjedhore dhe politike.

GQZ i rekomandon Avokatit të Popullit që të:

- 1** Caktoj një nga zëvendësit e Avokatit të Popullit të merret ekskluzivisht me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;
- 2** Monitoroj zbatimin e legjislacionit përkatës dhe të nxjerr rekomandime për institucionet të cilat nuk zbatojnë atë apo e zbatojnë në mënyrë të pjesshme;
- 3** Hetoj dhe përcjell shkeljet individuale apo kolektive ndaj personave me aftësi të kufizuar;
- 4** Ofroj rekomandime në hartimin e politikave publike dhe legjislacionit në lidhje me personat me aftësi të kufizuar, për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje dhe jetën publike;

5 Ofroj qasje në informacione, materiale dhe ndërveprim me personat me aftësi të kufizuar duke siguruar që:

- Materialet e printuara, televizive dhe elektronike përdorin kontrast të lartë të ngjyrave;
- Këto materiale përmbajnë informacion të qartë dhe të thjeshtë;
- Materialet televizive, ato për ueb faqe, rrjete sociale të përfshijnë mesazhe në audio dhe në gjuhë të shenjave; dhe
- Materialet e printuara janë në dispozicion në formate të cilat janë të kuptueshme nga persona me aftësi të kufizuar në të parë, duke përfshirë shkrimin Braille;
- Komunikimin direkt me pëfaqësuesit e Avokatit të Popullit të bëhet duke siguruar interpretim në gjuhën e shenjave.

Çka mund të bëjë Qeveria e Kosovës ?

Qeveria e Kosovës si degë ekzekutive ka përgjegjësinë e implementimit të ligjeve të aprovuara nga Kuvendi dhe për më tepër ajo duhet të zbatojë edhe aktet nënligjore të miratuara nga vet Qeveria. Qeveria e Kosovës është pakrahasimisht organizata më e madhe buxhetore dhe përbën shtyllën e administratës shtetërore. Prandaj angazhimi i Qeverisë së Kosovës në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe politike, është i një rëndësie kyçe, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte. Përmes ministrive të saja përkatëse Qeveria mund të ndihmojë në arritjen e shumicës së objektivave të cilat sigurojnë pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe ato politike.

GOZ i rekomandon Qeverisë së Kosovës të:

- 1 Sigurojë zbatim të plotë të legjislacionit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike;
- 2 Sigurojë zbatim të plotë të udhëzimit administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- 3 Sponzorojë projektligje në Kuvend të cilat nxisin dhe përmirësojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore politike;
- 4 Bashkëpunoj me KOZ që të sigurohet qasje e plotë për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha qendrat e vendvotimeve;
- 5 Bashkëpunoj me KOZ dhe PZAP për të siguruar qasje të plotë të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha lokacionet të cilat përdoren për qëllime zgjedhore, të tilla si zyrat e KOZ dhe KKZ dhe qendrat e numërimit të rezultateve dhe të lehtësojë parashtrimin e ankesave.

Çka mund të bëjë sektori privat ?

Sektori privat mund të ndihmojë palët e interesit të listuara më lartë në sigurimin e qasjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore dhe politike, duke ndarë një pjesë të fondeve të përgjegjësisë shoqërore korporative për të adresuar disa nga problemet. Sektori privat mund të kontribojë sidomos në sigurimin e qasjes së plotë fizike në objekte publike dhe në ofrimin e materialeve në formate të qasshme.

GQZ i rekomandon sektorit privat të:

- 1 Kontriboj në sigurimin e plotë të qasjes fizike në qendra të votimit dhe institucione tjera publike, duke ndërtuar pjerrina, ashensor, dhe të ngjajshme.
- 2 Trajnoj personat me aftësi të kufizuar në shkathësi të ndryshme si shkathtësitë e menaxhimit, shkathtësitë kompjuterike, dhe të ngjajshme, të cilat do të jenë të dobishme për pozita në procese zgjedhore dhe politike.
- 3 Ofroj materiale rreth proceseve zgjedhore dhe politike, në formate të qasshme, si shembull informatat për votues në video që kanë interpretim në gjuhë të shenjave, në shkrimin Braille, dhe në formate të tjera të qasshme.



○ Grupi për Qasje në Zgjedhje
○ Grupa za Pristup Izborima.
○ Election Access Group

PJESA 2

Personat me aftësi
të kufizuar
si lider/e

Pjesa e dytë e udhëzuesit
përshinë një listë të personave
me aftësi të kufizuara të cilët kanë
mbajtur pozita udhëheqëse politike
dhe zgjedhore në disa shtete në
150 vitet e kaluara.

Argjentinë

Në vitin 2015, Gabriela Michetti ishte zgjedhur Zëvendës-Presidente e Argjentinës. Ajo ka qenë senatore e Buenos Aires që nga viti 2013. Në vitin 2007 ishte gruaja e parë e zgjedhur Zëvendës-Kryetare e Buenos Airesit. Ajo është përdoruese e karrocës që nga viti 1994 kur ka pësuar aksident trafiku.

Ekuador

Lenin Voltaire Moreno Garcés ka shërbyer si Zëvendës-President i Ekuadorit nga viti 2007 deri më 2013. Para se të zgjedhet Zëvendës-President ai ka qenë një administratorë i lartë në industrinë e turizmit. Ai ka qenë i nominuar për çmimin Nobel për paqe në 2012 për punën e tij me personat me aftësi të kufizuar. Ai është paraplegjik nga një plaçkitje e armatosur në vitin 1998.

Australi

Gregor McGregow ishte udhëheqës i Unionit Tregtar, kryetar i Partisë së Bashkuar të Punëtorëve dhe anëtar i Këshillit Legjislativ të Australisë së Jugut në fund të shekullit të XIX. Më 1901 ai ishte zgjedhur Senator në Parlamentin e parë Australian, ku ka shërbyer deri më 1914 si ministër kabineti dhe shef i grupit të tij parlamentar. Gjatë karrierës së tij ai u bë i verbër.

Figji

Iliesa Delana ka qenë ndihmës Ministër i Rinisë dhe Sportit dhe anëtar i zgjedhur i Parlamentit të këtij shteti që nga viti 2014. Në vitin 2012 ai ka fituar medaljen e artë në kërcim së larti në para olimpiadë. Ai ka humbur këmbën e tij nga një aksident në moshën tre vjeçare.

Belgjikë

Helga Stevens është anëtare e zgjedhur e Parlamentit Evropian, ku ajo mbanë pozitën e Zëvendës Kryetares së grupit parlamentar të konservatorëve dhe reformistëve euro-skeptik. Në vitin 2004 ajo u bë anëtare e Parlamentit Flaman, përderisa në vitin 2007 ajo u zgjodh anëtare e Senatit. Ajo ka lindur e shurdhër.

Greqi

Panagiotis Kouroumbilis është emëruar Ministër në Qeverinë Greke në vitin 2015, fillimisht si Ministër i Shëndetësisë dhe Solidaritetit Shoqëror dhe më vonë si Ministër i Rikonstruktimit të Brendshëm Administrativ. Ai ka humbur të pamurit në moshën dhjetë vjeçare. Ai është anëtar themelues i Sindikatës Botërore të të Verbërve.

Indonezi

Abdurrahman Wahid (Gus Dur) ka qenë president i Indonezisë në mes të viteve 1999 – 2001. Ai ka qenë një figurë e lartë religjioze, dekan universiteti, udhëheqës i organizatës Nahdlatul Ulama (NU) në vitin 1984 ai ishte bërë udhëheqës i kritikëve të regjimit të Presidentit Suharto dhe po ashtu është themelues i Partisë së Zgjimit Kombëtar (OKB). Ai ka qenë pothuajse tërësisht i verbër pas një serie të goditjeve në vitin 1990.

Kanada

Diane Finley është zgjedhur për herë të parë në vitin 2004 anëtare e Parlamentit Kanadez. Në mes të viteve 2006 dhe 2015 ajo ka mbajtur disa pozita të larta, duke përfshirë postin e Ministres për Resurse Njerëzore dhe Zhvillim të Shkathtësive, Ministre e Punëve Publike dhe Shërbimeve Qeveritare dhe Ministre e Emigracionit dhe Shtetësisë. Ajo ka shikim të kufizuar si pasojë e sëmundjes Graves.

Mbretëri e Bashkuar

Tanni Grey-Thomson anëtar i Dhomës së Lordëve, pjesëmarrës i pesëfishtë i Para olimpiadës në mes të viteve 1988 dhe 2004 dhe fitues i 16 medaljeve. Ajo është anëtare e bordit në disa organizata, duke përfshirë Transportin për Londrën dhe Korporata për Zhvillim Trashëgimor të Londrës dhe kryetare e Grave Sportiste. Ajo ka lindur me "Spina Bifida" dhe është përdoruese e karrocës.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Tony Coelho ka qenë anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-vë në vitet 1978 dhe 1989, si përfaqësues i Distriktit të Kalifornisë. Ai ka qenë udhëheqës i mazhorancës që nga 1986 deri më 1998 dhe është konsideruar si sponsor kryesor Aktit Amerikan për Persona me Aftësi të Kufizuar. Në vitin 1963 ai u diagnostifikua me epilepsi.

Tammy Duckworth në vitin 2012 është bërë grua e pare me aftësi të kufizuar e zgjedhur si anëtare e Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuar. Ajo ka qenë në të kaluarën burkrate e lartë në Departamentin Shtetëror të Illinoisit për Çështje të Veteranëve. Ajo ka të amputuara të dy këmbët si rezultat i lëndimeve të marra gjatë shërbimit si pilote në Irak.

Zelandë e Re

Mojo Mathers ka qenë anëtar i parë i zgjedhur i shurdhër i Parlamentit të Zelandës së Re në vitin 2011, pas një përfshirje të gjatë si aktivist mjedisor dhe si këshilltar i politik në Partinë e Gjelbër. Ajo ka lindur e shurdhër.



○ Grupi për Qasje në Zgjedhje
○ Grupa za Pristup Izborima.
○ Election Access Group

PJESA 3

Standardet
bazike për qasje

Të dhënët më poshtë janë të bazuara në udhëzimin administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar. Qëllimi kryesor i këtij udhëzimi është që të përcaktoj standardet e qasjes së personave me aftësi të kufizuar në objektet publike. Udhëzimi administrativ përfshin të gjitha institucionet publike dhe ato private të cilat u shërbejnë një numri më të madh të njerëzve.

Sipas këtij Udhëzimi, elementet obligative për qasje janë:

Elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme, që përfshijnë ashensorët, shkallët, rampat, platformat vertikale dhe platformat palosëse;

Elementet e qasjes për jetë të pavarur;

Objektet të cilat janë të obliguara të sigurojnë qasje sipas udhëzimit administrativ

Objektet tregtare:

Shtëpitë e mallrave

Qendrat tregtare dhe marketet me sipërfaqe 400m²

Baret, kafenetë dhe restorantet me kapacitet 80 apo më shumë persona

Diskotekat dhe klubet e natës me sipërfaqe mbi 400m²

Qendrat turistike, apo zyrat informative turistike dhe agjencitë me sipërfaqe mbi 200m²

Hotelet dhe qendrat e tjera hoteliere me kapacitet 50 e më shumë dhoma

Restorantet afër rrugëve magjistrale, autostradave

Ndërtimet postare dhe ato me destinim të telekomunikimit

Hallat postare me tri apo më shumë sportele

Objektet e tjera postare me destinim të shërbimit të palëve me më shumë se tre sportele

Institucionet financiare

Filialet e bankave

Agjencitë financiare

Filialet e agjencive financiare me tre apo më shumë sportele

Objektet e shërbimeve administrative

Institucionet lokale dhe rajonale

Administrata shtetërore

Objektet qeveritare

Objektet e Kuvendit

Gjykatat

Objektet e tjera të cilat ofrojnë shërbime juridike publike

Objektet e shërbimeve shëndetësore, sociale dhe rehabilituese

Zyrat e shërbimit të furnizimit social-shëndetësor

Barnatoret dhe dyqanet për shitjen e mjeteve ndihmëse ortopedike

Ambulancat, shtëpitë e shëndetit, spitalet dhe shtëpitë shëruese

Pishinat shëruese, banjat, shtëpitë e të moshuarve apo për persona me aftësi të kufizuar me 20 apo më shumë dhoma

Byrotë e shërbimit kujdesit social, shëndetësor për punë me palë, kuzhinat popullore

Ndërtesat në të cilat më së shumti qëndrojnë personat me aftësi të kufizuar

Ndërtesat ku janë të vendosura shoqatat, unionet apo asociacionet e personave me aftësi të kufizuar

Institucionet edukuese, arsimuese, rehabilituese apo strehuese të personave me aftësi të kufizuar

Institucionet e arsimit dhe edukimit

Çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve

Shkollat

Universitetet

Konviktet e studentëve me kapacitet më të madh se 50 dhoma dhe objektet e ngjashme

Ndërtesat e dedikuara për kulturë

Bibliotekat universitare

Qendrat e kulturës dhe ato të kongresit

Muzetë, galeritë dhe hapësirat për ekspozita 300m²

Kinematë, teatri dhe sallat koncertale me 100 e më shumë vende

Ndërtimet e dedikuara për komunikacion

Stacioni i autobusëve apo hekurudhës, peroni hekurudhor

Aeroportet

Parkingjet publike

Vendpushimet pranë autostradës

Garazhet publike me kapacitet prej 300 e më shumë automjete

Pompat e benzinës

Ndërtimet e dedikuara për sport dhe rekreacion

Sallat sportive për 100 e më shumë persona

Terrenet sportive

Ndërtimet për shërbime fetare dhe sakrale

Halla ceremonial

Qendra humanitare

Ndërtimet e dedikuara për argëtim

Parqet argëtuese

Kopshtet zoologjike

Kopshtet botanike

Institucionet korrektuese

Burgjet

Shtëpitë korrektuese

Institucionet rehabilituese

Hapësirat publike

Sheshet e këmbësorëve

Rrugët

Shtigjet e parqeve

Lojërat e fëmijëve

Nënkalimet dhe mbikalimet

Urat për këmbësorë dhe kalimet rrugore

Objektet kolektive banesore

Objektet banesore me
dhjetë apo më shumë banesa

Të tjera

PanaiRET dhe qendrat e ekspozitave

WC-të publike


Kapella dhe krematoriumi

StrehimoreT publike

Si të bëhet qasja ?


Rampa

- Pjerrësia e rampës : 5% (1:20)
- Gjerësia e rampës: 120 cm jashtë, minimumi 90 cm brenda
- Gjatësia e pushimores: 150 cm së paku, e vendosur në çdo 6 m të gjatësisë së rampës.
- Dorëza mbajtëse: diametër 4 cm, e vendosur në dy lartësi prej 60 cm dhe 90 cm




Shkallët

- Lartësia e shkallës: deri 15 cm
- Gjerësia e sipërfaqes shkelëse: jo më e vogël se 33 cm
- Gjerësia e hapit të shkallës: 110 cm në hapësira të mbyllura, 120 cm në hapësira të jashtme




Ashensorët

- Dimensionet e brendshme të ashensorit: 110x140 cm
- Gjerësia e derës së ashensorit: së paku 90 cm
- Ndriçim vizual dhe lajmërim tingëllues në kate.




Toaleti

- Dorëza në dyer dhe dritare: 90 cm për dyer, për dritare në lartësi prej 90 cm deri 120 cm
- Guaskë me dërrasë për ulje në WC: në lartësi 45-50 cm
- Dy mbajtëse për duar të vendosura në mure: gjatësia 90 cm, lartësia 80-90 cm
- Pajisje për lëshimin e ujit në guaskë: 70 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë
- Lavaman: gjerësia së paku 50cm, 80 cm lartësia




Kuzhina



- Hapësirë të lirë për lëvizje me karrocë për Personat me Aftësi të Kufizuar në hapësirat e brendshme: minimumi 150 cm
- Hapësirë për lëvizje rreth mobileve: me gjerësi më së paku 120 cm



Dhoma, klasa, hapësira e punës

- Tavolinë pune konzoll: sipërfaqja e sipërme më së larti 85 cm, shikimi në lartësi më së paku 70 cm me thellësi qasje më së paku 50cm
- Shenjat për qasje duhet të jenë të pranishme
- Gjithmonë të ketë hapësirë për lëvizje të karrocës
- Standardet tanimë të përmendura për gjerësinë e dyerve dhe prezencës së dritareve nëpër dhoma.





UDHËZUES

PËR PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA PËR PJESËMARRJE
NË PROCESET ZGJEDHORE DHE POLITIKE





USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

